

Thirrje për Skenograf

Shkodër, 13/01/2019


Pozicioni: Skenografi për Teatrin Social
Titulli i projektit: Arti kundër dhunës
Afati përfundimtar i aplikimit: dt 23/01/2019
Periudha e angazhimit: Dhjetor 2018 – Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Arti kundër dhunës” zbatohet në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë. Projekti “Arti kundër dhunës” përfshin aktivitete të ndryshme, të cilat materializohen në organizimin e mësimeve jo-formale argëtuese me të vegjël të qytetit (arte figurative dhe muzikë), si edhe me organizimin e një sërë aktiviteteve artistiko-sportive (koncerte, ekspozita, teatër, etj.) me të rinjtë dhe shtresat vulnerabel.

2. Qëllim i kontratës

Qëllimi i kontratës është përgatitja e skenografisë për 3 shfaqjet teatrale të cilat trajtojnë problematikën që hasen nga femrat që janë viktime të dhunës. Aktoret që do të interpretojnë do të përzgjidhen mes vetë femrave të dhunuara duke sjellë dëshmi reale. Shfaqjet teatrale do të vihen në skenë në qytetin e Shkodrës.



3. Detyrimet e Skenografit

Aktiviteti i skenografit nis menjëherë pas nënshkimit të kontratës.

Ai është përgjegjës për përgatitjen e ambientit ku do të mbahet shfaqja. Skenografi mban kontakt të vazhdueshëm me regjizorin dhe plotëson kërkesat e këtij të fundit.. Shfaqjet teatrale do të vihen në skenë në qytetin e Shkodrës. Lidhur me çdo problematikë të mundshme, skenografi duhet të raportojë tek regjizori i shfaqjes.

6. Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata nis menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe mbaron në 30 Maj 2019.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

i. të detyrueshme


- a. Kandidati duhet të zotërojë diplomë Bachelor në një ndër fushat e Arteve Pamore;
- b. Të ketë eksperiencë pune minimalisht 3 vjeçare.
- c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë;
- d. Të jetë i aftë për punë.

ii. te preferueshme

- a. Të jetë banor në Shkodër;

8. Dokumentacioni

- Letër motivuese ku te shprehet oferta financiare;
- Jetëshkrimi (CV), ku të përfshihen eksperiencia e punës;
- Kopje e ID;



- Fotokopje e Diplomës;
- Vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore “i aftë për punë”;
- Letër reference nga një punëdhënës i mëparshëm (të specifikohen kontaktet e plota të punëdhënësit);
- Vetëdeklarim gjendjen gjyqësore “i padënuar me vendim të formës së prerë”.

Kandidatët që shpallen fitues duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar nga kontraktuesi dokumentacioni si më poshtë:

- Vërtetim banimi;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjendjes shëndetësore

9. PAGESA

Pagesa për Skenografin do të realizohet sipas kontratës që do të lidhet me Fondacionin Arte.

10. APLIKIMI

Aplikimi duhet të dorëzohet **brenda dt. 23/01/2019**, me email në:

fondacioniarte@gmail.com

ose

me postë, në adresën zyrtare të Fondacionit ARTE
Rruga e Kavajës, Pallati 223, Shkalla 3, Kati 4, Apartamenti 23, Tiranë

Përgjigja e rezultateve jepet me email pas tri - pesë ditëve, që nga përfundimi i aplikimit. Kandidati duhet të paraqitet pranë Fondacionit ARTE për nënshkrimin e kontratës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.